



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 143 dt. 24.12.2014

Në mbështetje të nenit 30 dhe nenit 32 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 24.12.2014, pasi shqyrtoi propozimet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit për shpalljen Monument Kulture Kat. II (dytë), për objektin “Ish Arqipeshkvia e Durrësit në Delbnisht, Rrethi Laç, Qarku i Kurbinut”.
2. Miratimin e propozimit për shpalljen Monument Kulture Kat. II (dytë), për objektin “Banesa e Abat Prend Doçit, Rubik, Rrethi Mirditë, Qarku Lezhë”.
3. Miratimin e propozimit për rishpalljen Monument Kulture Kat. I (parë) dhe Zonë e Mbrojtur për “Kisha e Shën e Premtes, Lukovë Sarandë”.
4. Miratimin e propozimit për shpallje “Zonë e Mbrojtur për Manastirin e Ardenicës”.
5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

